



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI SH.A
Ferizaj

Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel & Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

Duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Neni 8.1, Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Nr. 07/2017; Rregulloren mbi Sistematizimin e Punëve dhe Detyrave të Punës të KRU Bifurkacioni SH.A Nr.775 të datës 24.12.2007 si dhe Rregullores mbi Themelimin e Marrëdhënies së Punës, Nenet 4, 5, 7, dhe 8, **Kryeshefi Ekzekutiv i KRU Bifurkacioni SH.A Ferizaj**, shpallë:

K O N K U R S

Për vendet e lira të punës në KRU Bifurkacioni SH.A - Ferizaj:

- I. Lexues-arkëtues, dy (2) pozita, një (1) pozitë për zonën e shërbimit Ferizaj dhe një (1) pozitë për zonën e shërbimit Kaçanik;
- II. Ujë-instalues, dy (2) pozita për zonën e shërbimit Ferizaj;
- III. Sigurim Fizik, një (1) pozita për zonën e shërbimit Kaçanik;
- IV. Punëtor fizik, një (1) pozitë për zonën e shërbimit Kaçanik;
- V. Zyrtar për Menaxhim të Debitorëve dhe Kontratave të Konsumatorëve, një (1) pozitë për zonën e shërbimit Ferizaj;
- VI. Inxhinier i Hidroteknikës, një (1) pozitë për zonën e shërbimit Ferizaj.

Kushtet:

Për vendet e punës me nr. rendor 1, 2, 3, 4:

- Përgatitja shkollore: Shkolla e Mesme,
- Përvoja e punës, e dëshirueshme.

Për vendin e punës me nr. rendor 5:

- Përgatitja shkollore: Fakulteti i Ekonomik, Administratë Publike
- Përvoja e punës, së paku një (1) vjeçare në drejtim përkatës e obligueshme.

Për vendin e punës me nr. rendor 6:

- Përgatitja shkollore: Fakulteti i Ndërtimtarisë – Drejtimi i Hidroteknikës,
- Përvoja e punës, së paku një (1) vjeçare në drejtim përkatës e obligueshme.

Përgatitja profesionale, detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

I. Lexues-arkëtues:

- Kryen pagesa të faturave të ujit në terren;
- Është përgjegjës për inkasimin e faturave për ujin e faturuar në një zonë të caktuar;
- Në bazë ditore dorëzon mjetet e inkasuara në arkën e kompanisë;
- Mban përgjegjësi për mjetet e inkasuara deri në dorëzimin e tyre në arkë;
- Është përgjegjës për dhënien e ndihmës në zbulimin e kycjeve ilegale dhe keqpërdorimeve të ndryshme të ujit;
- Është përgjegjës për hartimin e listave dhe rexhistrave të konsumatorëve të cilët nuk janë të rregullt me pagesa;
- Ka për detyrë të përgjigjet dhe të adresojë më tutje në kompani vërejtjet dhe pakënaqësitë eventuale të konsumatorëve;
- Sipas rregulloreve në fuqi bën leximin e ujëmatësve;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacionet e programeve Word, Excel dhe Power Point;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit;
- Kryen edhe punë të tjera, me kërkesën e përgjegjësit të tij, të cilit i përgjigjet për punën e të tij.

II. Ujë-instalues:

- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në zonën e shërbimit të kompanisë
- Kryen të gjitha llojet kycjeve në rrjet si edhe montimin e profileve të ndryshme të ujëmatësve,
- Bën montimin e të gjitha dimensioneve dhe profileve të ujësjellësit si edhe pjesëve fazonike duke përfshirë të gjitha llojet e lidhjeve,
- Është përgjegjës për materialin me të cilin ngarkohet si gjatë orarit të punës ashtu edhe pas kryerjes së punëve për të cilin obligohet ta sistemojë në vendodhje të sigurt apo ta kthej në depo,
- Është i obliguar që të njohë rrjetin e ujësjellësit e sidomos vendin ku gjenden pjesët fazonike dhe elementet tjera,
- Është përgjegjës për ngarkimin e punëtorëve fizik me detyra dhe vegla dhe të njejtit i njofton me punët në teren si dhe me shfrytëzimin e mjeteve,
- Është e domosdoshme që të ketë njohuri bazike në leximin e projekteve, skemave dhe detajeve tjera,
- Është përgjegjës për disiplinën e punëtorëve të vet në kryerjen e detyrave të punës ,
- Punon në menjanimin e prishjeve në rrjetin e ujësjellësit në qytet dhe në lagjet periferike,
- Kryen edhe punë të tjera, me kërkesën e përgjegjësit të tij, të cilit i përgjigjet për punën e të tij.

III. Sigurim Fizik

- Është përgjegjës për ruajtjen dhe sigurimin e pasurisë së luajtshme dhe të pa luajtshme të kompanisë;
- Është përgjegjës për dhënien e ndihmës në zbulimin e vjedhjeve, dëmtimeve dhe shkeljeve tjera ligjore dhe kryerësve të tyre, veçanërisht në ruajtjen e provave materiale nga vendi i ngjarjes për organet kompetente;
- Bën ndalimin e hyrjes për personat e pa njohur brenda objekteve dhe hapësirave të kompanisë;
- Është përgjegjës për kontrollimin e hyrjes-daljes së mallrave brenda hapësirës së kompanisë nga punëtorët apo personat e tjerë me theks të veçantë tek mallrat apo objektet e ndaluara si droga, alkooli, armët etj. ;
- Është përgjegjës për përditësimin e librit të kujdestarisë duke mbajtur evidencë të hyrje-daljeve të punëtorëve dhe vizitave zyrtare;
- Merr pjesë në mbrojtjen kundër zjarrit;
- Kryen punë tjera të ngjashme me urdhëresë të kryepunëtorit.

IV. Punëtor Fizik

- Është përgjegjës për ngarkimin dhe shkarkimin e materialit të sistemit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Është përgjegjës për ngarkimin dhe shkarkimin e mjeteve të punës dhe materialeve tjera të ngurta si dheut, rërës, zhavorrit etj.;
- Punon në hapjen e kanaleve për rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe në mbulimin e tyre;
- Bën rrafshimin e vendit të punës;
- Kryen punë tjera të ngjashme me urdhëresë të kryepunëtorit.

V. Zyrtar për Menaxhim të Debitorëve dhe Kontratave të Konsumatorëve

- Është përgjegjës për monitorimin e nivelit të pagesave të debitorëve,
- Është përgjegjës për monitorimin e nivelit të implementimit të kontratave të konsumatorëve,
- Mban kontakte të vazhdueshme me konsumatorët debitorë të kompanisë,
- Mban kontakte të vazhdueshme me konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratave,
- Harton raporte dhe dokumente specifike, në baza ditore, javore dhe mujore për konsumatorët debitorë si dhe kategoritë e veçanta të konsumatorëve sipas kërkesës së përgjegjësit;
- Kryen edhe punë të tjera, me kërkesën e përgjegjësit, të cilit i përgjigjet për punën e të tij.

VI. Inxhinier i Hidroteknikës

- Bën dizajnimin dhe projektimin e instalimeve të Hidroteknikës përkatësisht instalimeve të ujit dhe kanalizimit për projektet e zhvilluara nga kompania;
- Kryen analizë të plotë për fazën e Instalimeve të Hidroteknikës përkatësisht instalimeve të ujit dhe kanalizimit, për nevojat e kompanisë – Projekteve;
- Bën rekomandime profesionale lidhur me projektet e punuara nga kompanitë projektuese për nevojat e kompanisë;
- Kryen punë të tjera lidhur me ndërtimet duke përfshirë dhënien e njohurive profesionale për menaxhmentin, përmirësimin e projekteve ekzistuese si dhe pjesëmarrjen në implementimin e projekteve të kompanisë, etj;
- Bën organizimin, ofron mbështetjen përmes dhënies së instruksioneve për kontraktorët e kompanisë dhe mbikëqyrjen e realizimit të punëve nga ana e tyre konform planifikimit dhe organizimit të punëve dhe caktimit të prioriteteve;
- Planifikimin e kryerjes së punëve, angazhimin e resurseve dhe mbikëqyrjen e punës;
- Informimin e udhëheqësve për mbarëvajtjen e punëve, në pajtueshmëri me nevojat dhe kërkesat në vend-punim;
- Është përgjegjës për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të shënimeve dhe raporteve mbi punët e kryera dhe ato të planifikuara dhe raportimin e rregullt të punëve tek udhëheqësit e kompanisë;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe Menaxheri Operativ (MO).

Dokumentet e nevojshme:

- Aplikacioni për punësim – Kërkesa;
- Diploma e përgatitjes shkollore dhe kualifikimeve tjera;
- Ekstrakti i lindjes, jo më i vjetër se 6 muaj;
- Letërnjoftimi fotokopje;
- Vërtetimi se nuk ushtrohet procedurë hetimore nga Gjykata, jo më i vjetër se 6 muaj.

Aplikacioni për punësim mund të shkarkohet në ueb-faqen e kompanisë ose të tërhiqet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Zyra nr. 1 - KRU Bifurkacioni, ku edhe bëhet dorëzimi i aplikacionit së bashku me dokumentacionin e kërkuar, në zarf-pliko të mbyllur. **Afati i konkursit për aplikim është i hapur 15 ditë**, nga dita e publikimit në ueb-faqen e kompanisë dhe në shtypin ditor, duke filluar **nga data 03.11.2022 e deri më 17.11.2022**, prej orës 9.00 h deri në ora 15.00 h. Telefoni për kontakt 044/210-208.

Ferizaj,
02.11.2022

Kryeshefi Ekzekutiv
Jeton Shabani